



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
And Cooperation SDC



HELVETAS
Swiss Intercooperation

ALBANIA

REHABILITIMI I FUSHË DEPOZITIMIT TË MBETJEVE NË BASHKINË PUKË

PLANI LOKAL PËR MANAXHIMIN E
INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE
NË BASHKINË PUK



Vend-depozitimi i Pukës ka shërbyer si vendepozitim mbetjesh urbane duke filluar që në muajin gusht të vitit 2012. Grumbullimi i mbetjeve të Bashkisë së Pukës në këtë vend u evidentua si zgjidhje e përkohshme e problemit të mbetjeve urbane. Më parë ato depozitoheshin pa asnjë kriter, disa metra larg nga vendepozitimi në fjalë, duke u shpërndarë në të gjithë kodrën ku ndodhet vend-depozitimi aktual. Hapja e këtij vend-depozitimi pasoi me mbylljen e të mëparshmit dhe grumbullimin e mbetjeve në vend-depozitimin e sotëm të Pukës. Vend-depozitimi manaxhohet nga Bashkia Pukë, ku NJA Pukë dhe Qerret depozitojnë mbetjet e tyre në zonë.



Strategjia Kombëtare e Mbetjeve⁷ rekomandon zbatimin e aktiviteteve të parandalimit, riciklimit apo ripërdorimit dhe trajtimit të mbetjeve me rikuperim energjie, para se mbetjet të përfundojnë në vendet finale të asgjësimit të tyre, pra në landfille sanitare. Duke marrë në konsideratë statusin aktual të manaxhimit të mbetjeve urbane në vend, janë përcaktuar standarte dhe janë vendosur afate konkrete⁸ për përmirësimin e kushteve teknike dhe mjedisore për të gjithë vendet e depozitimit të mbetjeve urbane dhe përdorimit të impianteve të kontrolluara dhe inxhinierike për trajtimin final të mbetjeve.

Sipas VKM 452/2012 për landfillët e mbetjeve, njësitë vendore që kanë në administrim një vendepozitim për mbetjet urbane, pavarësisht nëse janë pajisur me leje mjedisi, brenda 2 viteve⁹ nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duhet të përgatisin një plan përmirësimi të vendepozitimit dhe ta paraqesin atë për miratim pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pasi miraton planin e përmirësimit, ia dërgon atë për shqyrtim Komitetit Ndërmintor për Mbetjet, i cili vendos për masat që duhen marrë dhe periudhën e nevojshme të tranzicionit për përbushjen e tij. Periudha e tranzicionit nuk duhet të zgjatë më shumë se 8 (tetë) vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Vend-depozitimi i Pukës ndodhet në Qafën e Qerretit. Kjo qafë është formuar nga bashkimi i shpateve të dy gungave relativisht të larta duke marrë një formë konike të lehtë. Forma konike ka favorizuar grumbullimin e dherave përreth si rezultat i rrëshqitjes së dheut të shtyrë nga forca e gravitetit ose pjerrësia. Shtresa e dheut në vendin ku është hapur gropa e vend-depozitimit arrin deri në 3m thellësi. Vend-depozitimi është rreth 60 metra i gjatë dhe rreth 45 metra i gjerë, me sipërfaqe 2,700m². Gropa e vend-depozitimit arrin deri në 4 metra thellësi¹⁰. Vend-depozitimi ka një kapacitet prej 10,800m³. Rreth 1/2 e volumit të vend-depozitimit është e mbushur me mbetje. Pjesa tjetër mendohet të mbushet gjatë 2-3 viteve të ardhshme¹¹. Vendepozitimi i mbetjeve urbane është ndërtuar dhe përdoret prej vitit 2012, duke zëvendësuar vendin e mëparshëm të depozitimit të mbetjeve, ngjitur me të. Projekti i rehabilitimit të vend-depozitimit të mbetjeve, përfshinte edhe punimet për mbylljen e fushës së vjetër të mbetjeve ashtu dhe rikonstruksionin e rrugës nga rruga ekzistuese kombëtare (Qafë-Qerret) deri në fushën ku depozitohen mbetjet urbane, gjatësia e këtij segmenti rrugë është 1050 m.



Në vend-depozitimin e Pukës depozitohen mbetje urbane nga NJA e Pukës dhe NJA e Qerretit. Mbetjet depozitohen rreth 3-4 herë në javë dhe arrijnë një mesatare prej rreth 4 ton mbetje urbane të ngurta në ditë. Sipas të dhënave të Bashkisë Pukë, këtu shkarkohen mbetjet urbane të të gjitha llojeve, nga komponentët organikë, mbetje të riciklueshme dhe mbetjet e përziera.



Situata mjedisore e venddepozitimit të Fushë Qarrit

Nga informacionet e mbledhura më parë dhe nga vizita në terren rezulton se vend-depozitimi i mbetjeve në Pukë nuk respekton standardet minimale mjedisore dhe teknike. Ky vend-depozitim është thjesht një gropë e hapur nga Bashkia e Pukës me përmasat e cituara më sipër. Gropa nuk ka asnjë shtresë apo veshje në pjesën e saj të poshtme apo anësore që të shërbejë si pengesë për depërtimin e shllamit në ujërat sipërfaqësore e nëntokësore të zonës, ose në tokë. Si shtresë mbrojtëse shërben vetëm shtresa e dheut ose toka mbi të cilën hidhen mbetjet. Shkalla e kontrollit gjatë pranimit të mbetjeve në fushë është tepër e ulët. Bashkia kontrollon vetëm makinat e transportit që ka vetë në operim dhe deklaron se nuk kemi shkarkime informale apo nga palë të tjera në fushë. Shkarkimi i mbetjeve bëhet në një sipërfaqe të dizenuar për këtë qëllim nën vëzhgimin e personelit (shoferit të makinës teknologjike, ndërkohë mungojnë roje apo punonjës të tjerë në fushë). Si rezultat mbetjet nuk kontrollohen, peshohen apo rregjistrohen.

Ndërkohë nuk merret ndonjë masë për kontrollin e përhapjes së mbetjeve nga era, përhapjen e mizave dhe parazitëve apo edhe të baltës nga lëvizja e makinave, kontrollit të zjarreve (nuk ekzistojnë djegiet rutinë të mbetjeve, apo nuk ekzistojnë dhe zbatohen procedurat për parandalimin e zjarrit dhe fikjen e tij në raste emergjence apo aksidentale). Shkalla e monitorimit dhe e verifikimit të kontrollit mjedisor pothuajse nuk



ekziton, nuk ka kontroll mbi ujrat sipërfaqësore dhe nëntokësore, manaxhimin e shllamit dhe gazit, etj. Si rrjedhojë, shqetësimi kryesor që ngre grumbullimi i mbetjeve në vend-depozitime të papërshtatshme si ai i Pukës është ndotja e ujërave sipërfaqësore e nëntokësore me metale të rënda si Pb, Cd, As and Cr, Zn, Ba, Mn, Cu, Co, Ni, Br, me kripëra si sulfate, nitrate dhe kloride, me metale radioaktive si U, Sr, Rb, Nd, Sb, Sm dhe V dhe me ndotje baktetologjike. Nëse lihen të pakontrolluara, ujërat e ndotura që rrjedhin nga fusha e mbetjeve, mund të emigrojnë (nëpërmjet rrjedhjeve ose depërtimit) në përrrenjtë e zonës ose t'i bashkohen ujërave nëntokësore të akuiferit të zonës. Ka shumë mundësi që sasia e rrjedhjeve në këto burime të shtohet edhe më shumë në kohën e rreshjeve. Në vend-depozitimin e Pukës, emigrimi i ndotjes në ujërat sipërfaqësore ose nëntokësore mbetet një shqetësim. Kjo për arsyen se përroi i Muhamet Beqirit dhe ujërat që rrjedhin nga vend-depozitimi bashkohen në pjesën juglindore të venddepozitimit, vetëm në largësinë 1m nga gropa. Si rrjedhojë, rrjedha e përroit të Muhamet Beqirit merr me vete ujërat e ndotura që rrjedhin nga ky vend-depozitim. Pasi bashkohet me shkarkimet e lëngëshme të vend-depozitimit, në largësinë 1-2km, përroi i Muhamet Beqirit bashkohet me përroin që rrjedh drejtpërsëdrejtë nga Rezervuari i Pukës. Mbas këtij bashkimi, përroi i Muhamet Beqirit së bashku me përroin që buron nga rezervuari i Pukës, rrjedh në drejtim lindje-veri-perëndim dhe bashkohen me Përroin e Gomsiqes mbas 5-6km. Ky i fundit derdhet në liqenin e Vaut të Dejës.



Konkluzione

Në përfundim të procesit të vlerësimit të vend-depozitimit të mbetjeve në Pukë, kemi këto rezultate:

a) Venddepozitimi aktual (prej 2012) i mbetjeve urbane në Pukë, rezulton një zhvillim pozitiv në krahasim me vendet e mëparshme për depozitimin e mbetjeve (tashmë të mbyllura dhe sistemuara), për shkak se:

- Hedhja dhe depozimi i mbetjeve bëhet në mënyrë të kontrolluar, duke mos lejuar përhapjen e tyre në një territor të gjerë;
- Ndodhet larg qendrave të banuara dhe burimeve ujore;

b) Vend-depozitimi aktual nuk përmbush kërkesat teknike-ligjore për pranimin, ruajtjen, mbulimin, mbikqyrjen dhe monitorimin e depozitimit të mbetjeve në vend-depozitim:

- Edhe pse mbetet për t'u verifikuar nëpërmjet monitorimit të cilësisë së ujit, ka mundësi që të ketë ndotje të ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore në afërsi të fushës së mbetjeve, për shkak se mungon një sistem për grumbullimin dhe trajtimin e shllamit të mbetjeve dhe ujrave të shiut. Zgjidhja e dhënë për largimin e ujrave të shirave dhe shllamit është jo e qëndrueshme dhe e efektshme pasi lejon përhapjen e gjerë të ndotjes në zonat përreth fushës dhe një zonë më të largët, duke ndotur ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe shtresat e tokës përreth;
- Nuk garantohet mbrojtja e tokës, nëpërmjet barrierës gjeologjike (koeficienti i përshkueshmërisë është 1.0×10^{-9} m/sekondë ose më i vogël se kaq; trashësia është 1 m ose më e madhe se kaq, dhe mbulimi me shtresë izoluese artificiale për grumbullimin e lëngjeve që kullojnë nga venddepozitimi dhe izolimi i shtratit (pjesës së poshtme) të venddepozitimit);
- Mungon ruajtja, kontrolli gjatë pranimit të mbetjeve urbane që shkarkohen në venddepozitim, rrjedhimisht rreziku për praninë e mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve të tjera të papranueshme në venddepozitim është i lartë;
- Mungon kontrolli ndaj zjarreve (ekzistojnë djegiet rutinë të mbetjeve, nuk ekzistojnë dhe nuk zbatohen procedurat për parandalimin e zjarrit dhe rastet aksidentale.

c) Bashkia nuk ka sot një plan përmirësimi, si detyrim i:

- Sipas pikës 25 të VKM (452/2012), "Operatori i një venddepozitimi ekzistues, pavarësisht nëse ka ose jo leje mjedisi, brenda 2 (dy) viteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, përgatit një plan përmirësimi të lëndfillit dhe e paraqet atë për miratim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Ky vendim ka hyrë në fuqi në Gusht të vitit 2012 dhe sipas tij brenda Gushtit të vitit 2014 të gjitha bashkitë duhet të kishin hartuar një plan për përmirësimin e venddepozitimeve ekzistuese.



Rekomandime

Masat e mëposhtme teknike dhe operacionale duhet të merren në konsideratë:

Hartimi i një plani për përmirësimin e venddepozitimit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe nevojat specifike për operimin e venddepozitimit dhe për të minimizuar ndikimet mjedisore;

Përcaktimi i një buxheti mujor nga ana e bashkisë për mirëmbajtjen e fushës, në të cilin duhet të parashikohet edhe një fuqi punëtore (1 punonjës) si manaxher të fushës (1 turn 8 orarësh), i cili mund të luajë edhe rolin e rojës të fushës (kjo në varësi të buxhetit të bashkisë);


Depozitimi i mbetjeve duhet të zhvillohet në ditë të caktuara (sipas një kalendari të përcaktuar javor), ku manaxheri i fushës është përgjegjës për regjistrimin e të dhënave ditore në lidhje me: i) llojin e mbetjeve që duhet të hyjnë në vend depozitim; ii) numrin e shkarkimeve që ndodhin në venddepozitim; iii) numrin e mjeteve që shkarkojnë mbetjet në venddepozitim; iv) sasia e mbetjeve që hyjnë çdo ditë në venddepozitim; v) komente të ndryshme në lidhje me mbetjet që hyjnë në venddepozitim;

Duhet të ndiqet një procedurë për reduktimin e sipërfaqes në të cilën punohet në vend depozitim. Rekomandohet që në vend depozitim të punohet me qeliza dhe pjesa tjetër e territorit të jetë e mbuluar me dhe'. Konkretisht do të ndërmerren këto hapa:

Mbulimi i të gjithë sipërfaqes së fushës me dhe':
Sipërfaqja e fushës është $60 \times 45 = 2,700 \text{ m}^2$.

Depozitimi i mbetjeve të kryhet me qeliza me dimensione $20\text{m} \times 20\text{m} \times 2.5\text{m} = 1000\text{m}^3$ 1 qelizë, dhe qeliza me dimensione $5\text{m} \times 20\text{m} \times 2.5\text{m} = 250\text{m}^3$ 1 qelizë.

- 1 - Qelizë mbetjesh
- 2 - Rruga e mjetit teknologjik
- 3 - Sistem drenazhimi
- 4 - Baseni i ujrave të mbetjeve



FADROMË ME GOMA

Naftë: 22l/h
Vaj motorri: 325 l/vit
Vaj hidrauliku: 15 l/muaj
Graso: 25 kg/vit



BULDOZER ME ZINXHIRA


Naftë: 22l/h
Vaj motorri: 32l/vit
Vaj lubrifikues: 18 l/muaj
Graso: 25 kg/vit




KAMION

Naftë: 22l/h
Vaj motorri: 60l/vit
Vaj HIDRAULIKU: 45 l/vit
Vaj diferenciali: 50 l/vit





Qeliza 1




Qeliza 2




Hyrja

Punohet në një qelizë, ku mjeti ka rrugën e përcaktuar për të shkuar atje, dhe pjesa tjetër e fushës është e mbuluar me dhe' ose me materiale inerte. Pasi përfundon qeliza e parë ajo mbulohet me dhe' dhe kalohet në qelizën tjetër. Kapaciteti total i shtresës së parë me qeliza është $6,750m^3$.





Shtylla betoni me lartësi 2-3 m. Kërkohen 70 shtylla betoni.




Perimetri total që do të rrethohet është:
 $2 \times 58m + 2 \times 66m = 248m$



 Tubacion drenazhimi
 HDPE – Ø 160-200 mm

 Tubacion HDPE –
 Ø 200-400 mm

 Pompë

 Baseni për
 grumbullimin e
 shllamit

